



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranverorë

Kryesia e Kuvendit
P-025
Prishtinë, më 24 qershor 2008, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 24 QERSHOR 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Naim Maloku, Eqrem Kryeziu dhe Xhezair Murati, kurse munguan: Ibrahim Gashi dhe Sllobodan Petroviq;

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjaj, Lulzim Zeneli, Bojan Stojanovi dhe Zylfi Merxha, kurse munguan: Lutfi Haziri, Ardian Gjini dhe Ibrahim Makolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca ;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Rinor Beka .

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 10, 12 dhe 17 qershor 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 10, 12 dhe 17 qershor 2008

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 10, 12 dhe 17 qershor 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të propozuar, veç e veç.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e radhës të mbahet më 30 qershor 2008, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtur më 12, 13 dhe 19 qershor 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-43 për akreditimin,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën tatimore dhe procedurat,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Organit përzgjedhës lidhur me emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën kontestimore,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sponzorime në kulturë, rini dhe sporte,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë,

- Transport e Telekomunikacion lidhur me procedimin e Ligjit për miniera e minerale,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me procedimin e Ligjit për hulumtime gjeologjike,
 12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2007,
 13. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2007.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

- 3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me procedimin e Ligjit për ngrohje qendrore

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e këtij komisioni, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion që, në procedurën e rekomandimit për amendamentim, ta rishqyrtojë tekstin e Ligjit për ngrohje qendrore për ta harmonizuar preambulën dhe pjesën përfundimtare të tij me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

- 3.2 Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Driton Tali, i mbështetur edhe nga pesë deputetë të tjerë, për nxjerrjen e një deklaratë lidhur me formimin strukturave paralele komunale në enklavat serbe

Kryesia, pasi shqyrtoi mocionin e deputetit Driton Tali, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Mocioni i parashtruar nga deputeti Driton Tali për nxjerrjen e një deklaratë lidhur me formimin strukturave paralele komunale në enklavat serbe dhe të asaj lidhur me letrën e Sekretarit të OKB-së, z.Ban Ki Mun, nuk i plotëson kushtet formale, ngase nuk i ka nënshkrimet e nevojshme për procedim, të parapara me rregullat e procedurës.

- 3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit për lejimin e udhëtimit zyrtar në Ohër

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e këtij komisioni, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit, në Ohër, Maqedoni prej 26 deri më 29 qershor 2008, në këtë përbërje: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Xhezair Murati, Hydajet Hyseni, Fehmi Mujota, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Suzanë Novobërdaliu, Ismet Beqiri, Besa Gaxheri dhe Radmila Vujoviq, si dhe nga stafi i Administratës së Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Antigona Bajrami.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori - OSBE-ja, kurse mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr.02-242-1/06.

4.2 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kryesisë, Slobodan Petrović, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Denver, Colorado

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e anëtarit të Kryesisë, Slobodan Petrović, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Slobodan Petrović, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, për të marrë pjesë në Seminarin me temën: “Forumi Ndërkombëtar i Liderëve” në Denever, Colorado, prej 24 deri më 28 gusht 2008.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe mëditjet sipas paragrafit 1 të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Kuvendit

5. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se më 30 qershor dhe 1 korrik 2008 vijnë në Kuvend për vizitë zyrtare Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës Përfaqësuese të Belgjikës dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Sllovenisë. Ata duhet të pritën në Aeroportin e Prishtinës nga ana e Protokollit dhe më pastaj të shoqërohen nga stafi udhëheqës i Administratës së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale